

Termet e Referencës

“Dizajnim dhe zhvillim të platformës digjitale”

1. HYRJE

HANDIKOS, “Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës” është krijuar si reagim ndaj gjendjes së vështirë në të cilën gjenden personat me aftësi të kufizuara në Kosovë, e themeluar nga dhe për personat me aftësi të kufizuara, me aktivitete të pandërprera që nga viti 1983.

Si organizatë përfaqëson, përkrah dhe punon për dhe me personat me aftësi të kufizuara përmes avokimit dhe lobimit. Ofron shërbime të ndryshme përmes rrjetit të shtrirë në gjithë Kosovën dhe promovon barabarësinë, jetën e pavarur dhe me dinjitet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

2. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

HANDIKOS në partneritet me Save the Children në Kosovë është duke implementuar projektin “Advancing Rights and Participation of Children with Disabilities in Kosovo”, i cili financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (SIDA). Projekti përqendrohet në ndërtimin e kapaciteteve të fëmijëve me aftësi të kufizuara për të monitoruar të drejtat e tyre dhe për të ndikuar në vendimmarrje në nivel lokal.

3. OBJEKTIVA E DETYRËS

HANDIKOS do të zhvillojë një platformë digjitale që synon:

- Rritjen e qasjes në informacion të thjeshtuar mbi të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- Rritjen e ndërgjegjësimit mbi mekanizmat e pjesëmarrjes dhe raportimit;
- Krijimin e një mekanizmi të sigurt dhe të qasshëm për raportimin e shkeljeve dhe barrierave;

Platforma do të kontribuojë në forcimin e mekanizmave të monitorimit dhe avokimit për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Lidhur me këtë, HANDIKOS kërkon kompani për dizajnimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen teknike të një platforme digjitale (web dhe mobile responsive), e cila:

- Ofron informacion të thjeshtuar, të qasshëm dhe miqësor për fëmijë;
- Mundëson raportim të sigurt dhe konfidencial të shkeljeve të të drejtave;
- Dizajni i platformës duhet të jetë i thjeshtë, i lehtë për t’u përdorur dhe të pasqyrojë skemën ekzistuese të ngjyrave të faqes handi-kos.org

Kërkesat e mëposhtme të dizajnit dhe përvojës së përdoruesit duhet të integrohen në procesin e zhvillimit:

- Platforma duhet të jetë e qasshme për të gjithë përdoruesit dhe e qasshme përmes pajisjeve desktop, tabletë dhe telefon.
- Platforma duhet të jetë e shfletueshme në këta shfletues: Google Chrome, Safari, Mozilla FireFox dhe Opera.
- Platforma do të zhvillohet dhe administrohet në dy versione gjuhësore: shqip dhe anglisht.
- Sistemi i Menaxhimit të Përbajtjes duhet të sigurojë administrimin dhe redaktimin e përbajtjes së faqes së platformës në një mënyrë të arritshme, efikase dhe fleksibile në mënyrë që të mënjanohet procesi i kontaktimit të kompanisë për futjen e informatave shtesë në platformë.
- Ofertuesi duhet të ofrojë sigurimin e shërbimeve për të parandaluar dhe luftuar rreziqet e sigurisë.

4. KUSHTET E PAGESËS

Pagesa do të bëhet sipas faturës përkatëse për kryerjen e shërbimeve. Pagesa do të bëhet pas përfundimit të zhvillimit të platformës/ pas aprovimit nga Save the Children Kosova dhe HANDIKOS.

HANDIKOS rezervon të drejtën e negociimit të propozimit financiar.

PROCEDURA PËR APLIKIM

Ofruesi i shërbimeve duhet të ofrojë informacionet e kërkuara më poshtë në mënyrë që propozimi i tyre të konsiderohet:

- Një historik të shkurtër të kompanisë dhe CV-të e personelit të propozuar;
- Plani i punës;
- Oferta financiare.

Ofertat duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: handikos@handi-kos.org
cc: nora.simitciu@handi-kos.org.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është 22 mars 2026, ora 16:00.

Pas përzgjedhjes kompania e përzgjedhur duhet të dërgojë:

- Certifikatën e regjistrimit;
- Vërtetimin tatimor;
- Certifikatën mbi dënimet penale/ përgjegjësi i kompanisë.
- Poashtu duhet të nënshkruaj **Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve** si dhe **Rregulloren mbi Parandalimin e Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual — PSHAS** dhe t'u përmbahen kushteve dhe kriterëve të tyre/ përgjegjësi i kompanisë.

Vetëm kandidatët e suksesshëm do të kontaktohen!